



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 55 datë 27-04-2023

PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES TË DATËS 30.03.2023
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 30.03.2023, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

V E N D O S I

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 30.03.2023 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 23 vota

Vota Pro 23

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 27-04-2023

K R Y E T A R
Erjon NEXHIPI

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 30.03.2023

Kryesuesi i mbledhjes është Kryetari i Këshillit Bashkiak z. Erjon Nexhipi

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes: në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 22

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej këshilltarësh: 22

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: 1

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me rendin e ditës ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PROCEVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 23 SHKURT 2023.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Material është shpërndarë, ka diçka nga këshilltarët?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1 – 28 SHKURT 2023.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e ndihmës ekonomike në relacionin e paraqitur nga Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, Drejtor i Kujdesit Social, Drejtore e Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK.Për periudhën Shkurt janë 57 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, "Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme" konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për muajin Shkurt 2023, është në dispozicion fondi prej 262.450 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike , nga sistemi i pikëzimit. Nga ky fond, përfitojnë 57 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 192.649 lekë. Po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 26 familje, në shumën 32.192 lekë. Pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 224.841 lekë. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor ,sipas kriterëve specifike të miratuara 16 familje, me fond prej 55.104lekë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Atëherë relacioni për miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social i strehimit, mbështetje financiare e interesave të kredisë përcakton specifikisht mbështetjen financiare të interesave të kredisë që synon të mbështesë mbi 10 familje mbi blerjen e shtëpive të para me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës. Prioritet ju jepet çifteve të reja, individë me

moshën jo më shumë se 35 vite, gra kryefamiljare dhe individë me familje të pakicave romë dhe egjiptiane. Sipas përcaktimeve në përgjigje të njoftimit publik janë paraqitur kërkesat, është administruar sasia e kërkesave dhe është përcaktuar sipas këtyre vlerësimeve ligjore, lista e familjeve që plotësojnë kushtet e mbështetjes financiare të interesave të kredisë me 5 familje sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kemi dhe listën të bashkëngjitur. I propozoj Këshillit Bashkiak miratimin e kësaj liste.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ekezkutivi ka diçka për të shtuar?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Janë disa material në rendin e ditës së sotme që kanë lidhje me programet dhe projektet e bashkisë për strehimin social. Strehimi social është shumë i rëndësishëm prandaj edhe e kemi patur një fokus të veçantë, drejtorja e strehimit social pranë bashkisë. Dy projektet për të cilat do të miratojmë materialet sot është skema e mbështetjes të interesit të kredisë dhe projekti tjetër është bonusi i strehimit apo mbështetja e qerasë për ato familje që përfitojnë nga kjo skemë. Skema të rëndësishme janë pjesë në fakt e programit të bashkisë për të mbështetur strehimin social, krahas këtyre 2 skemave ne jemi në kontakt me entin kombëtar të banesave edhe për të mundësuar vazhdimin e ndërtimit të banesave me kosto të ulët në qytetin e Korçës, që edhe këto janë banesa që janë kërkuar nga ata që kanë aplikuar për strehim social në zyrat tona, ndërkohë që shpresoj që shumë shpejt të fillojmë punën edhe me projektin tjetër që është po kaq i rëndësishëm, sic është përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet në nevojë, ku kemi aplikuar me një numër të madh objektesh edhe me banesa kolektive por edhe me banesa individuale në të cilën do të ndërhyet shumë shpejt. Ftoj të gjithë këshilltarët që ti miratojnë këto projekte me qëllim që ti hapim rrugën mbështetjes së vazhdueshme të atyre familjeve që kanë aplikuar pranë drejtorisë së strehimit social.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit tëditës

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.10 DATË 25.01.2023 "MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Do të sugjeroja që ti përmendnit të gjitha materialet që kanë të bëjnë me këtë çështje dhe votimin e bëjmë të ndarë.

Këshilltare I.Nikaj: Por janë të ndryshme në përmbajtje, ky dokument që është tani ka të bëjë me korrigjim në vlerën financiare. Ky material që ka ndryshimin e vendimit nr.10 datë 25.01.2023 ka të bëjë me korrigjimin e vlerave financiare për 3 familje që kanë marrë mbështetje financiare për qira si familje të pastreha dhe që ka të bëjë me ndryshimin e mbështetjes financiare që mbulohet nga fondi i bashkisë, fondi i buxhetit të shtetit dhe paraqitja e tyre është bërë në tabelën që shoqëron këtë relacion. Duke pasur parasysh këto ndryshime unë vlerësoj dhe ftoj këshillin bashkiak për ta miratuar këtë relacion për ndryshime në vendimin nr.10 datë 25.01.2023.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga ekzekutivi? Nga këshilltarët e tjerë?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

"PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Në këtë relacion është paraqitur një familje së cilës i akordohet mbështetje financiare sipas përcaktimeve ligjore dhe vendimeve që ka marrë Këshilli Bashkiak. Ftoj Këshillin Bashkiak për ta miratuar.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka nga këshilltarët diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës

"PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.71 DATË 28.06.2021 TË KËSHILLIT BASHKIAK" PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE TË KTHYERA NË FOND BANESE TË NDËRTUARA NGA ENTI KOMBËTAR I BANESAVE "

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Shtesa që përcaktohet që duhet të miratohet nga Këshill Bashkiak ka në bazë përfundimin e afatit 5 vjeçar të kontratës të qirasë me nr.2822 prot. datë 14.06.2017 për apartamentin banesë sociale, pronë e bashkisë Korçënr.pasurie 5/854+2-1, vol.26 faqe 18, ZK 8563, me sipërfaqe 90.1 m2, me adresën godina nr. 2/A, Hyrja 1 Ap.2 Korçë,dhe ka paguar rregullisht qiranë në vlerën totale 472,384lek. Pra i lind e drejta mbi bazën e vendimarrjes dhe ligjeve që të miratojë shtesën në këtë vendim të Këshillit Bashkiak nr.71. Privatizimin në vlerën 1,451,423 Lek të kësaj pasurieme përfitues Z.Petrit Muhamet Bazelli. Ftoj Këshillin Bashkiak për ta bërë miratimin e kësaj shtese në venimin nr.71 datë 28.06.2021 të Këshillit Bashkiak Korçë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 8 e rendit të ditës

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.100 DATË 30.06.2022 "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT"

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj Irena Nikaj.

Këshilltare I.Nikaj: Relacioni përcakton përbërjen e komisionit të strehimit dhe plotësimin e tij me anëtarë përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe 3 emra të rinj në përmbushje të detyrimit ligjor pra është paraqitur lista e përbër me anëtarë dhe kryetarët e komisionit. Ftoj këshillin bashkiak për ta miratuar këtë ndryshim që propozohet në komisionin e strehimit të bashkisë Korçë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Votimi bëhet për çdo emër apodo votohet si komision?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 9 e rendit të ditës

"PËR RIALOKIMIN E FONDEVE PËR SHPENZIMET E KRYERA TË PROJEKTIT AUTHENTIK ME FINANCIM TË HUAJ (IPA)".

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Ekzekutivi A.Shkodrani: Kjo është një procedurë standarte të cilën ne e kemi dorëzuar edhe disa herë të tjera në kuadër të zbatimit të projektit Authentik me fond të BE. Është i pamjaftueshëm fondi aktualisht i disborzuar nga donator dhe ne kërkojmë një fond prej 1,151,247 lekë për të mbuluar 3 aktivitetet e fundit dhe më pas ky fond do të rikthehet do të disburzohet përsëri nga donatorët. Është një procedurë të cilën e kemi kryer edhe disa herë të tjera.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni kemi?

Ekzekutivi A.Shkodrani: Komisioni po u mbledh dje dhe diskutuam, por nuk e di sot ndoshta për arsye personale.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Të tëra brenda standarteve janë, ne nuk kemi bërë ndonjë gjë jashtë standartit, nuk do shpikim kushtetutën. Nga këshilltarët ka diçka?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 10 e rendit të ditës.

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.168 DATË 24.11.2022 "PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2023".

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Ekzekutivi S.Prifti: Bëhet fjalë për pajisjen me autorizim të peshkatarëve amatorë të ujrave të brendshme të bashkisë që janë lumenjtë dhe përrenj të vegjël. Një propozim i përbashkët i Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Brendshme na detyron ne si bashki dhe kemi ngritur infrastrukturën e pajisjes me autorizim të sistemit , por tarifa vjetore e një peshkatarit amator do të vendoset për 1,000 lekë të vjetra në vit. Presim miratimin tuaj dhe është në të mirën e të gjithë peshkatarëve amatorë që të jenë më të mbrojtur më të qetë në aktivitetin e tyre. Është e përshkruar dhe në relacion.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 11 e rendit të ditës.

PËR NJË SHITESË MBI VENDIMIN NR.32, DATË 23.02.2023, PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË APLIKANTËVE (BANORË TË BASHKISË KORÇË) NË VIJIM TË PROGRAMIT TË QEVERISË SHQIPTARE “ PROGRAMI I KODIMIT”

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z.Julian Kodra, z.Joan Deli, znj.Mamica Nene, znj.Maria Dojçe.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në mbledhjen e kaluar ne kemi miratuar një mbështetje financiare e cila ka erdhur një shtesë e mbështetjes që ka bërë Qeveria Shqiptare për të gjithë ato të rinj dhe të reja që duan të bëhen pjesë e kurseve të trajnimit me fokus gjuhët e programimit. Siç edhe e kemi prezantuar herën e kaluar mbështetja e qeverisë për këta të rinj është në masën 100% ose deri në 30,000 lekë të reja për një pjesë të tyre në varësi të statusit si punëkërkues të papunë ose si punë kërkues është 50% deri në 15,000 lekë. Ne si bashki i jemi bashkëngjitur duke ofruar mbështetje në masën 25% të mbështetjes që jep qeveria vetëm për ata të rinj që përfitojnë 50% mbështetje. Kemi miratuar disa kuota në mbledhjen e kaluar për 3 prej akademive që janë përzgjedhur nga ana e ministrisë përkatëse. Ka nga një kuotë respektive për secilin prej 15 aplikantësh për secilën prej akademive. Ndërkohë që në materialin e kësaj rradhe propozojmë që në rast se ka kuota të lira për një akademi të caktuar ato kuota mund të kalojnë për të mbështetur studentë tek dy akademitë e tjera gjithnjë në varësi të fondit, derisa i gjithë fondi të plotësohet. Pra kemi mundësi që ta ezaurojmë këtë fond dhe ta japim mbështetjen maksimale duke shkuar tek të gjitha akademitë dhe tek të gjithë ata që kanë aplikuar. Ky është qëllimi i materialit që ju kemi paraqitur sot.

Ekzekutivi A.Dishnica: Nëse do të ketë aplikime nga studentë që jetojnë në Tiranë dhe bëjnë aplikime në Tiranë, por vendosen vetëm në qytetin ku do bëhen këto trajnime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po ke të drejtë, dhe ndryshim i dytë është që mbështetjen do ta afrojmë për ata të rinj/reja që janë nga Korça dhe që do ti ndjekin këto kurse trajnimi në Korçë. Këto janë ato 2 ndryshimet që propozojmë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 12 e rendit të ditës.

"PËR EMËRTIMIN E NJË SHESHI NË NDER TË "SELIM MUSTAFA MBORJA (VENXHA)".

(Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore dhe Emërtimeve) z.Pandi Bello, znj.Danjela Nasto, znj.Irena Nikaj , znj.Maria Dojçe.

Këshilltar P.Bello: Mu duk një rast shumë i shpejtuar dhe njerëzit nuk janë të informuar, përveç kësaj mendoj se nuk e di sa është e përshtatshme nga pikëpamja e çfarë përfaqëson më vonë për bashkinë emërtimi në këtë mënyrë si kërkohet se ndryshë këtu duhet themi emri "Anastas Lakshes". Kur ishim të vegjël vinim anash dhe shikonim trupin e balsamosur të Anastas Lakshes, botues i parë i librave shqip. Është një diskutim pak i gjatë sesa kaq. Mendoj se nuk janë të informuar njerëzit, propozoj të shqyrtohet në një rast tjetër dhe komisioni të ketë mundësi të diskutojë mirë, që të jetë korrekt dhe në mënyrë të sinkronizuar veprime të tilla. Nuk është mbledhur komisioni po them.

Këshilltare I.Nikaj: Të bëj një sqarim si anëtare komisioni. Unë nuk kam qënë për të marrë pjesë në mbledhjen e komisionit, nuk e di anëtarët e tjerë se me çfarë statusi kanë qënë, ndërsa për sa i përket statusit të emërtimeve pra unë mendoj se ndoshta duhet të marrë mendimi i komuniteteve përpara se të vije mendimi i komisionit apo dhe i Këshillit Bashkiak në lidhje me të. Pra është mirë që komunitetet që ne ju emërtojmë vendet, të diskutohet me ta nëse janë dakord, sepse duhet vendosur dhe një marrëdhënie në kohë midis asaj që propozohet dhe asaj që ata jetojnë përditë.

Këshilltare E.Menkshi: Dhe e dija faktikisht se isha në komisioni i kulturës apo jo profesor. Kam qënë prezent kur kemi emërtuar dhe kur kemi dhënë tituj nderi, nuk e di pse nuk e gjeta veten tek ky komision, është ngritur një komision i ri ?

Këshilltare I.Nikaj: Ky është i trashëgimisë, ai është i titujve të nderit.

Këshilltare E.Menkshi: Dakord, dhe diçka tjetër mesa kam dijeni për këtë rast është një propozim që vjen nga një profesor i departamentit Histori- Gjeografisë. Ai është profesor i historisë mesa kam dijeni unë që të mund të jepja detaje. Thjesht pyeta nëse është shqyrtuar kjo figurë dhe emërtimi i sheshit që kërkohet, dhe besoj se ajo çfarë parashtrahet këtu për figurën e Selim Mborjes, nuk pretendoj që ta njoh, nuk do të mund të hyja në detaje dhe të bëja analizën, por mesa është në dijeninë time, profesori që ka shkruar relacionin në lidhje me këtë figurë gëzon edhe mbështetjen e komunitetit që ka propozuar për ta nderuar këtë figurë me emërtimin e një sheshi. Në dijeninë time ndoshta do të ishte mirë që profesori ose një grup nga komuniteti të ishin prezent këtu në mbledhje dhe të mund ta diskutonim edhe më gjerë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kjo si kërkesë na ka ardhur dhe është diskutuar mos gaboj jo në mbledhjen e kaluar por para 2 muajsh nga Shoqata Mborjare dhe ata kanë kërkuar vendosjen e emrit Selim Mborjes një rrugë, dhe po ta mbash mend kam folur për personalitetin e Selim

Mborjes sa e njoh unë se nuk pretendoj se e njoh shumë dhe kam thënë që është një gjë që do ta shohim dhe do ta konsiderojmë dhe në rast se ju kujtohet edhe ju më keni mbështetur dhe më keni thënë që ka dhënë kontribute dhe ta diskutojmë këtë mundësi. Kërkesa ka erdhur nga kjo shoqatë, ne e kemi diskutuar si bashki se cilat janë mundësitë e vlerësimit të kësaj figure dhe kemi erdhur me këtë propozim që sheshi tek trekëndëshi e cila është edhe në afërsi të një zone ku janë dhënë dhe kontributet e Filantropisë nga ana e Selim Mborjes të marrë këtë emër. Tani unë bie shumë dakord me atë që thotë profesor Pandi që qyteti ynë ka dhe shumë figura të tjera që krahas kontributeve atdhetare shoqërore etj kanë dhënë edhe kontribute të Filantropisë dhe është një nga vlerat tona që kemi si qytet. I përmendi Pandi disa, Thoma Turtulli, Anastas Lakshe e shumë të tjerë, se nuk pretendoj që i njoh të gjithë. Pra patjetër që ka shumë personalitete të tjera që ne duhet ti vlerësojmë në një mënyrë apo në një tjetër dhe në mbledhjet tona e kemi diskutuar dhe më përpara dhe ka ardhur koha që duhet ta shtojmë dhe ta vemë në rend të parë të ditës, është mbase dhe ndërtimi i një panteroni ndoshta për të nderuar të gjitha këto figura të filantropisë, por duke folur për Selim Mborjen nuk është se po lemë mënjanë gjithë personalitetet e tjera. Tani për figurën e Selim Mborjes ju e keni në material një përshkrim më të detajuar, nuk e di se sa e keni pasur mundësinë për ta lexuar aktivitetin e tij, e cila është në shumë dimensione, në çështjen e biznesit patjetër dhe në aktivitete pjesa e shoqatave të ndryshme, aktivitet shoqëror, sportive. Besoj se është një figurë në këndvështrimin tim si kryetar bashkie që e meriton këtë vlerësim, dhe përgjegjësia e këtij këshilli apo këshillit tjetër që të mendojmë për ti nderuar edhe të gjithë ata filantropët e tjerë, kurse përsa i takon shqetësimit të profesore Irenës kjo është çështje procedure, bëhet pjesë edhe drejtoria juridike në rast se kërkohet një konsultim më i thelluar rreth zonës ku do të kryhet vendosja e emrit. Është çështje ligjore, në rast se ligji e kërkon dicka të tillë do e respektojmë, në rast se nuk e kërkon nuk mendoj se duhet ta vështirësojmë procedurën. Prandaj ekziston bashkia, këshilli i bashkisë i cili është organi që përcakton vendimarrjen e komunitetit të bashkisë Korçë dhe që ka kompetenca të caktuara. Pra besoj se e ka të përcaktuar ligji cilat kompetenca këshilli i ushtron për shkak se është organ përfaqësues i vullnetit të komunitetit dhe cilat janë ato procedura që për këtë vendimarrje këshillit i duhet dhe një lloj konsultimi me ligjin. Për ta përmbyllur do të propozoja që ta miratojmë këtë material dhe të futim me prioritet pastaj edhe vlerësimin për ndërtimin e një panteroni të këtyre figurave që kanë dhënë kontribut sidomos në pjesën e filantropisë por mund të jetë edhe një lloj ndërhyrje e një forme tjetër, mund ta diskutojmë sëbashku.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët?

Këshilltare I.Nikaj: Një sqarim, pra problemi është që ne mund ti kombinojmë demokracinë e deleguar me demokracinë e drejtpërdrejtë dhe të risillet kjo kur kemi të bëjmë me figura që janë në kohë larg asaj që jetojnë njerëzit në të përditshme, mund të ketë parasysh, nuk them që është çështje e ligjit. Përsa i përket sasisë apo numrit të atyre që duhen nderuar unë e kam dhënë edhe më parë mendimin tim dhe mendoj ta risjell pavarësisht sesa vlerësohet për diversifikimin për mënyrën se si vlerësohen figurat që kanë dhënë kontribute të cmuara për Korçën, me e rëndësishme që e mendoj është e vendosjes së kontaktit të drejtpërdrejtë. Mundet që tabela në një shesh të mos vendosë atë komunikim në kohën që ne na nevojitet, ka forma që të gjithë mund ti kemi parë se si edukatorë, filantropë, njerëz të shquar të pushkës dhe të penës mundet të vihen në marrëdhënie me gjeneratat që jetojnë apo me ata që vizitojnë këtë rajon, pra ka forma shumë të ndryshme dhe shprehëse dhe vlerësuese të cilat mund të përdoren dhe jo thjesht ti vendoset emri i një rruge siç është rasti tani etj me rradhë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe unë e ndaj këtë mendimin tuaj që krahas kësaj formës tradicionale do e quaj të nderimit të një figure që është emërtimi i një rruge i një shkolle, i një sheshi mund të shikohen dhe forma të tjera patjetër, por për rastin konkret mendoj që ai propozimi dhe figura e justifikon këtë vendimarrje që ne po ju propozojmë sot që ta merrni, pastaj mund të bëhet patjetër një diskutim se cilat janë mënyrat që kontributi i tyre psh është shumë e rëndësishme që kontributi i tyre të njihet nga brezi i ri që është një prej sfidave të kohës se duke u larguar nëkohë shumë gjëra edhe harrohen, dhe mbase kjo vënia e emërimit të një sheshi, vendosja e një pllake atje mbase nuk ja u komunikon në masë atyre kontributin që ka dhënë Selim Mborja, por është një shënjë ku ata mund të marrin një sinjal, të ngacmohen për të bërë një kërkim të mëtejshëm. Patjetër duhet shumë punë, pjesë e programeve shkollore, aktiviteteve të ndryshme që mund të organizohen nga bashkia, nga shoqatat. Pra nuk them jo vetëm për nderimin e kësaj figure por edhe për të gjithë figurat e tjera me kontribut me të madh ose më të vogël duhet të qëndrojnë vetëm këtu, ka shumë gjëra të tjera që mund të bëhen, të shohim edhe forma të tjera por edhe këto tradicionalet besoj se mund të përdoren.

Këshilltari A.Verushi: I bashkohem edhe mendimeve të tjera por edhe mendimit të kryetarit për vlerësimin e figurës të Selim Mborjes . Do të vlerësoja edhe dëshirën e bashkisë për të pozicionuar emërtimin e një sheshi. Emërtesa bëhet në një zonë që kalohet vazhdimisht nga banorë të Mborjes, është afër zonës ku ka dhuruar tokën për Spitalin Rajonal, kështu që kjo gjetje e bën të mundur që të kordinohet shumë mirë një lloj pëlqyeshmërie nga banorët por dhe njëkohësisht zgjidhjes që i ka dhënë bashkia për emërtimin e këtij sheshi. Kështu do të ftoja të gjithë këshilltarët që të mos meremi me emra të përvecëm, nëse do të vijmë patjetër propozime për vlerësime të figurave të tjera patjetër që do të ketë edhe një miratim nga këshilltarët. Mos humbasim kohë për këtë rast.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka?

Këshilltar P.Bello: Unë propozoj të shikohet dhe njëherë tjetër nëse doni, unë mund të them dhe gjëra të tjera.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nuk më duket me vënd ndërhyrja nga ana juaj profesor. Kush është dakord me emërtimin e sheshit në kryqëzimin e rrugëve Fan Noli, Avni Rustemi dhe Partizani me emërtesën Selim Mborja.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Pika 13 e rendit të ditës.

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE", TË BASHKISË KORÇË, SIPAS DOKUMENTIT BASHKËNGJITUR.

(Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve) z.Raqi Themeli, z.Kristi Andrea, znj.Sara Koroveshi, z.Klaus Bacelli.

Këshilltar R.Themeli:Për menaxhimin e integruartëmbetjeveështë një detyrim ligjor. Unë mendoj se duhet përgjegjësi, për këto 100 kazane plastike që do të vendosen në qytet dhe në fshat, në qytet bëhet fjalë vetëm për lagjet 1,2,3 dhe shqetësimi është duhet të ketë një program sensibilizimi me popullatën, pavarësisht ligjeve.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Menaxhimi i integruar i mbetjeve është një prej përgjegjësi kryesore të një bashkie dhe një prej atyre funksioneve tona të cilën ne duhet të kushtojmë vëmendjen dhe kujdesin maksimal. Për të arritur tek një menaxhim i integruar patjetër që ka shumë sfida përfshirë edhe atë që ju përmendët, pra ndërgjegjësimin e popullatës e komuniteteve në qytete dhe në fshat për riciklimin, ripërballimin e mbetjeve me qëllim që në të ardhmen gjithnjë dhe më pak mbetje të konsiderohen të papërdorueshme të shkojnë në landfill. Gjithë pjesa tjetër e mbetjeve duhen të riciklohen të ripërdoren dhe të rifuten edhe njëherë në ekonomi. Në këtë këndvështrim ndërgjegjësimi është shumë i rëndësishëm dhe siç e shoh unë ndërgjegjësimi duhet të fillojë që nga moshat shumë të vogla sepse pastaj në rast se dikush rritet me një edukatë apo një mënyrë të caktuar të sjelljes në raport me mbetjet dhe në raport me mjedisin është shumë e vështirë për të ndryshuar. Prandaj dhe ne në bashkëpunim me këtë kompaninë e menaxhimit të mbetjeve dhe në qarkun e Korçës kemi ideuar disa projekte të cilat patjetër duhet të shtohen në të ardhmen të cilat synojnë pikërisht këtë ndërgjegjësimin e komuniteteve për riciklimin e mbetjeve. Jo më larg se para disa ditëve kam qënë pjesë e një sfilate të organizuar në qyteza e fëmijëve nga kompania në bashkëpunim me qytezën me pjesëmarrjen e fëmijëve të cilët kishin përdorur mbetjet në formën e veshjeve dhe kostumeve të ndryshme me të cilat organizuan këtë sfilatë. Është një aktivitet i cili jep pikërisht atë mesazhin dhe sensibilizon moshën kur realisht mund të formësohet një person me një qëndrim të caktuar ndaj mbetjeve dhe mjedisit. Aktivitetet të tilla do të vazhdojmë në të ardhmen do të bëjmë patjetër një plan të detajuar. Ndërkohë që për pyetjen e parë të japë Nardi shpjegimin.

Ekzekutivi L.Gjanci: Ne kemi filluar prej disa kohësh riciklimin në qytet në 5 lagje të qytetit, lagjet karakteristike me kalldrëm 1,2,3, 11 dhe 12 ku kemi shpërndarë qeset jeshile derë më derë dhe i mbledhim ato të diferencuara letër, plastike alumin qelq edhe metal. Na ka rezultuar me efikasitet dhe në programimin që po bëjmë në kuadrine riformatimit të të gjithë kontratës do ta shtojmë këtë edhe në lagje të tjera me shtëpitë private që janë lagjia 4,5 dhe 13, kështu që është gati gjysma e Korçës do të kalojë me qese derë më derë, ndërsa gjysma tjetër e Korçës do të jenë ato 100 kazanë që thotë Raqi në blloqet me pallate do të vendosim në gjysmën e qytetit të Korçës 100 kazanë plastikë për ndarjen në burim të tyre. Gradualisht pasi ta përfundojmë në qytet do të fillojmë edhe në fshatrat në njësitë administrative për të arritur në një standart që na kërkohet sipas direktivave të BE në fund të vitit 2025 duhet të kemi arritur të riciklojmë 10% të mbetjeve.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi Nga këshilltarët ka diçka?

Këshilltare E.Menkshi: Furnizimi me material në rastin e qeseve do të bëhet nga bashkia, qyetarët do të paguajnë diçka?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo do të shpërndahen nga kompania që bëjnë grumbullimin e mbetjeve në qytet .

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 14 e rendit të ditës.

"PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 5 TË MARRËVESHJES NR.10216/1 PROT. DT.22.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi kemi dikë?

Ekzekutivi A.Dishnica: Në nëntor kemi shkruar një marrëveshje midis bashkisë dhe ujësjellës kanalizime Korçësi agjent tatimor, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Korçë.Në marrëveshje janë përcaktuar në mënyrë të ndërsjelltë të drejtat dhe detyrimet e palëve që do të lindin nga zbatimi i objektit të marrëveshjes. Në pikën 5 të marrëveshjes është përcaktuar se Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a. në rolin e agjentit tatimor, përfiton 2% komision të llogaritur mbi shumën totale të taksave dhe tarifave vendore familjare që ka arkëtuar dhe rakorduar si dhe kalon në favor të Bashkisë 98% të shumës së arkëtuar."Me qëllim llogaritjen në mënyrë të saktë të shumës prej 2% komision, është e nevojshme që Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë të bëjë kalimin e 100% të shumës së arkëtuar nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore familjare, për llogari të Bashkisë Korçë dhe kjo e fundit të bëjë kalimin për llogari të shoqërisë, të komisionit në masën 2%, të llogaritur mbi shumën totale të taksave dhe tarifave vendore familjare të arkëtuara nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi:Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? Është thjesht procedurë mesa kuptova unë.

Këshilltare I.Nikaj: Si është proceduruar më përpara? I kanë marrë ujësjellësit këto që janë mbledhur.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ujësjellësi vepron si agjent tatimor për mbledhjen e tarifave mos gaboj që nga viti 2008. Kemi qënë bashkia e parë, që nga momenti që kemi marrë ujësjellsat në administrim kemi bërë këtë zgjidhje për mbledhjene tarifave dhe taksave vendore për popullsinë,

ndërkohë që gjatë vitit të kaluar ujësjellësi kaloi dhe në këtë procesin e riorganizimit duke u bërë ujësjellës rajonalë. E kemi diskutuar disa herë këtu në materialet që kanë ardhur për këtë çështje dhe tani kompania administron 5 bashki, Korçë, Maliq, Kolonjë, Devoll, Pustec dhe orientimi edhe nga agjensia kombëtare ujësjellës-kanalizime dhe menaxhimit të mbetjeve është vendosur si rregull që në rast se ujësjellësi do të veprojë si agjent tatimor do të ketë dhe një komision sic e ka dhe ligji. Tani pa bërë këtë ndryshimin duhet të na kalonte ne diferencën, ndërkohë që ne po hemi na i kalo ne të gjitha dhe ne të të japim pastaj 2% sepse e kemi më të lehtë nga ana e kontabilitetit, për këtë është ky materiali që po propozojmë sot. Pra tarifë nuk kemi paguar më përpara. Nuk vepronte si agjent tatimor më përpara dhe nuk i paguanim komision. Pastaj bënë një unifikim ata sepse bashkia e Devollit i paguante ujësjellësit kur e menaxhonte vetë, bashkitë e tjera nuk e di, dhe është vendosur si praktikë e unifikuar edhe me aksionerët kryesorë të ujësjellësit që të jetë një masë e komisionit si agjent tatimor në masën 2%. Bën sens sepse bën një lloj punë për këtë gjë si agjent tatimor dhe duhet paguar. Tani ky është teknikalitet na i mbajnë të gjithën që në fillim dhe ja u kthejmë më vonë këtë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ne e paguajmë si shërbim po them dhe bën shumë sens për kontabilitetin.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 15 e rendit të ditës.

"PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT GJYQËSOR TË FORMËS SË PRERË".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë)
z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petriti.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Anxhela mund të na informosh më shumë. Dhe nga emërtesa ka nevojë për sqarim, do kujdeseni pak.

Ekzekutivi A.Dishnica: Në vitin 2014 është nënshkruar një marrëveshje me një shoqëri LANDRI-Y SHPK me objekt "Shitjen e makinerive të dala jashtë përdorimit" ku pas procedurës së shitjes në ankand, kjo shoqëri ka dalë fituese e ankandit. Kjo shoqëri gjatë zbatimit të kontratës ka pretenduar mungesë të sasisë të skrapit objekt kontrate, pretendim i cili u kontestua nga Bashkia Korçë. Për këtë qëllim është prishur kontrata duke kërkuar gjyqësisht përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktore. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendim 447 dt 21.09.2015 ka vendosur: Pranimin e pjesshëm të padisë. Kundër vendimit Nr. 447 dt 21.09.2015 paditësi Landri-y ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë e cila me vendim 254 dt. 07.02.2020 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr.447dt 21.09.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur Bashkia Korçë të përmbushë detyrimin kontraktor të kontratës së

shitjes dt. 07.05.2014 dhe të furnizojë palën paditëse me 98.52 ton skrap në vlerën e parapaguar prej 5,136,565.2 lekë pa TVSh.Sasia totale e skrapit që disponon bashkia dhe ndërmarrjet e varësisë është 41,332 kg në total.Për këtë qëllim i është kërkuar shoqërisë LARTI Sh.P.K bashkëpunim, për të vendosur në dispozicion të Bashkisë Korçë, sasinë totale diferencë që duhet për ekzekutimin e këtij vendimi. Shoqëria LARTI shpk ka shprehur mbështetjen e saj duke shprehur dakortësinë për të vendosur në dispozicion të Bashkisë Korçë sasinë prej 57,188 kg skrap.Për këtë qëllim do të nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe shoqërisë LARTI SHPK për të përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve.Këtë sasi skrapit, Bashkia Korçë dhe ndërmarrjet e varësisë duhet t'ia shlyejë shoqërisë në vitet pasardhëse sipas sasisë të grumbulluar në fund të çdo viti dhe nuk do të ndjekin procedurat e shitjes në ankand të sasisë së grumbulluar, deri në ekzekutimin e plotë të sasisë marrë shoqërisë LARTI Sh.P.K. Marrëveshja do të jetë pa afat derisa të shlyhet e gjithë sasia.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 16 e rendit të ditës.

"MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË KRYEJË TRANSPORTIN QYTETAS (URBAN) , ME SUBVENCION".

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z.Gjergji Kristo, z.Erjon Fecanji, z.Shkëlqim Kajmaku, z.Ermir Petruti dhe **(Komisioni i Shërbimeve Publike, Transportit, Lëvizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve)** z.Raqi Themeli, z.Kristi Andrea, znj.Sara Koroveshi, z.Klaus Bacelli.

Këshilltar R.Themeli: Përsa i përket subvencionit ne nuk vërejmë ndryshim, përsa i përket kriterëve nuk besoj se dhe ato do kenë dicka ndryshe. Në material janë të përcaktuara.

Ekzekutivi A.Dishnica: Në qershor mbaron afati i kontratës "Ortakëria Korça" sh.p.k. Në këto kushte lind nevoja për të filluar një procedurë të re konkurrimi për këtë shërbim. Kjo është një e drejtë ku parashikohet që Këshilli i Bashkisë duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet.Transporti qytetës kryhet vetëm me autobuzë nga shoqëritë të cilat e kanë të shprehur në aktet e themelimit si objekt të veprimtarisë, veprimatarinë e transportit të udhëtareve. E vetmja gjë që ndryshon është afati i kontratës, më përpara ka qënë 5 vjecar ndërkohë që tani propozohet që kjo kontratë të lidhet për 3 vjet duke u përputhur edhe me buxhetin afatmesëm i cili nuk na lejon të marrim përsipër shpenzime përtej afatit të buxhetit.

Hidhet në votim dhe miratohet.

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 17 e rendit të ditës.

INFORMACION; ANALIZA E SONDAZHIT NË LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT PËR PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM 2024-2026.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky është një informacion që është shpërndarë me email. Në komision ishte diskutuar, mund ta kalojë edhe ekzekutivi.

Këshilltare I.Nikaj: Cili komision?

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i financës, sepse janë sygjerime për prioritetet. Po ka diçka për të shtuar?

Këshilltare I.Nikaj: Meqënëse është një sondazh, që në një mënyrë apo në një tjetër pavarësisht nga pjesëmarrja e kufizuar qoftë nga numri qoftë nga cilësitë e atyre që kanë zgjedhur të përgjigjen në këtë sondazh unë mendoj që pavarësisht se në këtë që kemi ne nuk duken dhe aq qartë cilësimet për shkak se është bardh e zi, duhet parë me shumë vëmendje çfarë thonë të gjithë ata që janë përgjigjur në lidhje me së pari vlerësimin dhe së dyti prioritetet. Këtu nga materiali realizohet që shërbimi i kujdesit social për familjet dhe fëmijët renditet si shërbimi i parë që duhet mbajtur parasysh, i dyti papunësi strehim aftësim, i treti arsim profesional, i katërti kujdesi për personat e smurë dhe me aftësitë e kufizuara, i pesti mbështetje për zhvillimin ekonomik, i gjashti shërbimet bujqësore, i shtati pyjet dhe kullotat. Këto kanë zgjedhur të na evidentojnë nga sondazhi. Unë mendoj që është detyrë e bashkisë por dhe e KB që të ndërtojë një qasje shumë më cilësore për të gjitha ato që shfaqen si çështje të rëndësishme së veçantë nga vlerësimi i këtij sondazhi, pavarësisht se është në numër të kufizuar dhe ndoshta do të duhet të organizohet me më shumë qetësi dhe kujdesje një sondazh që të jetë më afër asaj që dëshirojnë të gjithë ata që jetojnë në qytet apo në njësitë administrative të bashkisë Korçë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në fakt është i disati vit që tentohet të bëhet, një vit ka pasur më shumë një vit më pak. Është një mënyrë shtesë për të dhënë sugjerime, për të vendosur prioritetet nuk është mënyra bazë.

Këshilltare I.Nikaj: Unë mendoj që mund të tregohen më në mënyrë të pavarur vlerësimet.

Pika 18 e rendit të ditës.

INFORMACION (KËRKUAR NGA ALEANCA E GRAVE KËSHILLTARE I.NIKAJ) (me e-mail)

Këshilltari I.Nikaj: Është një informacion për pjesën e projektit Strehëza emergjente për viktimat e dhunës në familje” është një projekt i cili ka si qëllim rritjen e sensibilizimit të popullsisë për të ndërgjegjësuar dhe rritur numrin e përfituesve për informim dhe sensibilizim. Është çështje prioritare si çështja e përparimit në pozicionin ashtu dhe përkujdesjen dhe në ato pjesëqë janë jo aq të përshtatshme sic është çështja e dhunës, viktimat e dhunës në familje midis gjinive, megjithatë ne do ti trajtojmë dhe do ti mbështesim në situata të kësaj natyre sepse sigurisht që çështja e dhunës në një shoqëri që ka probleme të thella të natyrës të marrëdhënieve, konflikteve natyrisht edhe e kombinuar kjo me çështjet e ndikimeve të të gjithë këtyre viteve që kemi kaluar , shqetësimet që kanë pasur në nivelin individual, personale dhe ndërpersonal duhet të trajtohen me kujdes dhe unë mendoj që qasjet mund të jenë të vështira.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga këshilltarët ka diçka për të shtuar? E quaj mbledhjen e mbyllur.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi



KRYETARI

ERJON NEXHIPI

